



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duke u bazuar në nenin 89, nenin 90 dhe nenin 91 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 08/L-294, nenin 8 të Ligjit numër 03/L-212 të Punës, nenin 5 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (MFPT) numër 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenin 2 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Gjakovës, shpall:

KONKURS PËR PRANIM

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar

Titulli i pozitës:	Aktor
Fusha e studimit:	Fakulteti i Arteve, drejtimi i Aktrimit
Klasa dhe koeficienti i pagës:	Klasa e Pagës K6, Koeficienti 8
Lloji i pozitës:	Krijues dhe Përformues i Artit dhe Kulturës
Institucioni:	Komuna e Gjakovës
Drejtoria:	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Njësia/Sektori:	Teatri i Qytetit “Hadi Shehu”
Data e njoftimit:	17.09.2026
Afati për aplikim:	18.09.2026 – 17.10.2026
Numri i referencës:	01-111/01-44358
Kohëzgjatja e kontratës:	Kontratë me periudhë të pacaktuar.

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- a. Të mësojnë tekstin dhe të mbajnë prova si dhe të hulumtojnë dhe lexojnë materiale apo të ndërmarrin aktivitete fizike dhe intelektuale që ndihmojnë në përgatitjen e rolit të tyre.
- b. Të diskutojnë interpretimin dhe të shfaqin kreativitet dhe të bashkëpunojnë me të tjerët dhe regjisorin.
- c. Të përformojnë drejtpërsëdrejti para publikut dhe të përformojnë në studio apo lokacion tjetër varësisht nga nevojat që paraqet produksioni.
- d. Të incizoj zërin varësisht nga nevoja e produksionit dhe të kujdesen për hapësirën performuese, kostumet dhe rekuizitat.
- e. Të mbajnë në mend tekstin dhe të gjitha funksionet tjera të veprës derisa ajo vepër zyrtarisht del nga repertori apo siç është e specifikuar në kontratë dhe të studiojnë veprën dhe punojnë në mënyrë krijuese për jetësimin artistik në përpunimin e rolit.
- f. Të bashkëpunon drejtpërdrejt me regjisorin e shfaqjes.
- g. Kryen dhe punë të tjera sipas kërkesës së drejtorit të teatrit në përputhje me natyrën e punës dhe përgatitjen e tij. Për punën e tij/saj i përgjigjet regjisorit, inspicientit dhe drejtorit të teatrit.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim:

- a. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- b. Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi.

- c. Të zotërojnë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- d. Të jetë i aftë për të kryer detyrën përkatëse.
- e. Të mos jetë i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- f. Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- g. Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- h. Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në Ligjin për Zyrtarët Publik.

3. Kërkesat e përgjithshme formale:

- a. Arsimimi i kërkuar: Diplomë të studimeve universitare në **Fakultetin e Arteve**, drejtimi i **Aktrimit**.
- b. Kërkesat specifike: Nuk ka.
- c. Përvoja e punës e kërkuar: Së paku **dy (2) vite** përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

4. Mënyra e aplikimit:

Aplikacionet merren në *Ambientet e Shërbimit me Qytetarë*, kati përdhese në ndërtesën e Komunës së Gjakovës si dhe mund të shkarkohet nga ueb faqja e Komunës së Gjakovës, dhe i plotësuar dorëzohet fizikisht në *Sektorin për Administrimin e Dokumenteve* apo të dërgohen me postë në këtë adresë: *Komuna e Gjakovës, Rruga "UÇK" numër 53, 50000 Gjakovë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Kati III.*

5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- a. Formulari i aplikimit, i plotësuar.
- b. Kopjet e dokumentit personal (*letërnjoftim ose pasaportë*).
- c. Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vendimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit e kontratës në këtë pozitë.
- d. Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale. Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i atij shteti, apo përmes dëshmisë së përkthyer dhe noterizuar të përvojës të lëshuar nga punëdhënësi përkatës.
- e. Kopjet e dëshmisë së trajnimeve.

Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit:

- a. Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.
- b. Dëshmi mjekësore se kandidati është në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse.
- c. Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (*lëshuar nga Gjykata Themelore*).
- d. Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (kandidatët që janë të punësuar apo kanë qenë të punësuar në institucione publike).

6. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- a. Vlerësimi përmes jetëshkrimit (*deri në 30 pikë*)
- b. Intervista përmes audicionit (*deri në 70 pikë*)

7. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare:

Përmes ueb faqes së Komunës së Gjakovës (gjakova.rks-gov.net) dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>), postën elektronike ose numrin e telefonit të deklaruar në aplikacion.

8. Sqarime shtesë:

- a. Dokumentet duhet të jenë në kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.
- b. Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (*jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi*).
- c. Kandidati përmes aplikacionit deklaron dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e procedurës së rekrutimit.
- d. Deklarimi i rrejshëm paraqet shkas për përjashtim nga procedura e rekrutimit.
- e. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.
- f. Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional siç specifikohet me legjislacionin në fuqi.